



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT



Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
ëëë.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201401474/2

Tiranë ___/___/2014

Lënda : *Rekomandime për përmirësimin e kushteve të qëndrimit dhe të trajtimit të të dënuarve dhe të paraburgosurve në IEVPenale Peqin.*

Drejtuar : Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve
Z. Artur Zoto

TIRANË

Drejtorit të IEVPenale
Z. Fatos Veliaj

PEQIN

Të nderuar zotërinj,

Avokati i Popullit, në rolin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës në mbështetje të nenit 19/1 të Ligjit nr.8454, datë 04.02.1999, "*Për Avokatin e Popullit*", i ndryshuar, inspektoi në datën 132.06.2014, IEVPenale Peqin. Inspektimi u krye nga ekspertet e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës Alfred Koçobashi, Alma Alibali në bashkëpunim me ekspertët e Shoqatës Përthyerje me qëllim verifikimin e respektimit të standardeve të përcaktuara në Ligjin Nr. 8328, datë 16.04.1998 "*Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim*", i ndryshuar; VKM Nr.303, datë 25.3.2009, "*Për Miratimin e Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve*"; Raportin vlerësues paraprak të delegacionit të CPT-së "*Për marrjen e masave në plotësim të*

rekomandimeve të tij”; rekomandimet e vazhdueshme të Avokatit të Popullit lidhur me kushtet e ambienteve të të burgosurve në këtë institucion, si dhe trajtimi i tyre nga ana e administratës së kësaj I EVP-je.

Në përputhje me procedurën e zhvillimit të monitorimit, grupi inspektues zhvilloi fillimisht takimin me drejtorin e institucionit dhe i komunikoi atij qëllimin e vizitës. Nga ana e funksionarit në fjalë u shpreh gatishmëria e tij personale, si dhe e stafit në drejtimin e tij për të realizuar të gjitha kërkesat e grupit monitorues.

Në takimin me drejtorin e I EVP Peqin, Z. Fatos Veliaj, i sapoemëruar prej dy ditësh në kohën e vizitës, grupi monitorues u informua për situatën e përgjithshme në institucion. Të dënuar që vuanin dënimin në këtë institucion ishin 750 të dënuar, kapaciteti i institucionit ishte 600 shtretër dhe mbipopullimi ishte 150 të dënuar; I EVP Peqin është i përbërë nga 4 seksione: seksioni i sigurisë së lartë, seksioni i sigurisë së zakonshme, seksioni i të paraburgosurve dhe seksioni i vëzhgimit; Të dënuarit e moshës 18-21 vjec mbaheshin në një seksion të vecantë; Të dënuar që ishin të vecuar me masën disiplinore të vecimit ishin 4 prej të cilëve 2 të dënuar dhe 2 të paraburgosur; Kishte 33 të dënuar me probleme të shëndetit mendor, por nuk ekzistonte një seksion i vecantë; Organika ishte e plotësuar, por kishin mungesa në sektorin e shëndetësisë për arsye të paaftësisë së përkohshme në punë (me raport të zgjatur mjekësor 2 mjekë).

Në vijim, u zhvilluan konsultime të frytshme me Përgjegjës të Sigurisë si dhe me zyrtarë të tjerë të këtij institucioni. Grupi monitorues mori informacionin e nevojshëm për kryerjen e detyrës pasi kontaktoi privatisht me personat e privuar nga liria, inspektoi të gjitha ambientet ku ata qëndrojnë, si dhe u njoh me të gjithë dokumentacionin e pasqyruar në regjistrat dhe aktet përkatëse.

Të dhëna të administruara gjatë takimit paraprak me funksionarë të IEV Penale Peqin

Me urdhër të Ministrit të Drejtësisë, I EVP Peqin është kategorizuar burg i sigurisë së lartë, me një seksion të sigurisë së zakonshme dhe një seksion paraburgimi. I.E.V.P Peqin është një institucion i cili strehon persona të gjinisë mashkullore, me statusin e të dënuarit (në sigurinë e lartë ose në atë të zakonshme, sipas vendimit të gjykatës) dhe të paraburgosurit.

Sipas informacionit paraprak të marrë nga drejtuesi i institucionit, grupmoshat e personave të paraburgosur në këtë institucion ishin të kategorise se grupmoshës madhore dhe te rinj (18-21 vjeç). Institucioni nuk strehonte të dënuar/paraburgosur të grupmoshës së mitur.

Përsa i përket ambienteve të tjera në rregjim, institucioni kishte 6 dhoma observimi, të cilat për shkak të mbipopullimit të madh në sektorët e kryerjes së dënimit, kishin humbur funksionin e tyre dhe përdoreshin si dhoma banimi, për të dënuar me konflikte në rregjim të cilët nuk kishin gjetur ende përshtatshmëri. Gjithashtu, në institucion kishte edhe 6 dhoma të veçimit nga aktivitetet e përbashkëta.

Nga ana e drejtuesit të Institucionit na u ofrua mundësia që të kishim akses brenda rregullave dhe pa vështirësi në të gjithë personat dhe ambientet që duhet të mbikqyrnim. Objektivi kryesor i kësaj vizite monitoruese ishin kushtet në përgjithësi dhe trajtimi i të dënuarve dhe paraburgosurve.

Trajtimi i të dënuarve/paraburgosurve dhe masat mbrojtëse

Grupi i inspektimit pati si objektiv mbledhjen e informacionit lidhur me trajtimin e të dënuarve/paraburgosurve, identifikimin e rasteve të përdorimit të torturës, trajtimin degradues e diskriminues, përdorimit të forcës fizike përtej kufijve të parashikuar në akte normative apo të presionit psikologjik ndaj kësaj kategorie, si dhe raste të marrjes së masave disiplinore të veçimit nga aktivitetet e përbashkëta.

Gjithsesi, nga bisedat në grup dhe në privatësi me vetë të dënuarit/paraburgosurit, gjendja e përgjithshme në drejtim të rasteve të torturës, trajtimin degradues e diskriminues, përdorimit të tepruar të forcës apo dhunës psikologjike nga ana e punonjësve të kësaj IEVP-je, paraqitej jo problematike.

Gjithashtu u mor informacion lidhur me pritjen e të dënuarve/paraburgosurve në institucion dhe funksionimin e komisionit të pritjes si dhe në plotësimin e regjistrave e dosjeve personale të të dënuarve.

Grupi monitorues vlerësoi dhe krahasoi me standardet ligjore masat mbrojtëse të përdorura në IEVP Peqin. Sipas informacionit të marrë, e për më tepër nga verifikimi në vend i praktikave respektive, rezultoi se pranimi i të dënuarve në institucion bëhej duke respektuar standardet ligjore të parashikuara dhe për rrjedhojë nuk u konstatuan shkelje të tyre.

Nëpërmjet verifikimit fizik të librit përkatës, u konstatua se respektohej e drejta e të dënuarve për të bërë ankesa, si drejtuar institucionit ashtu edhe jashtë tij por shpesh nuk merrnin përgjigje për ankesat e tyre. Në të gjitha seksionet mungonin kutitë e ankesave/kërkesave dhe të dënuarit ua dorëzonin ankesat/kërkesat edukatorëve të cilët i dorëzonin në sekretarinë e institucionit. Në institucion kishte pasur një ngjarje të rëndë në datën 9 qershor 2014, ku në mjediset e ajrimit ishte goditur nga 4 të dënuar i dënuari Mario Bejdollari. I dënuari ishte plagosur dhe kishte një të carë në kokë, që ishte qepur nën mbikqyrjen e mjekut të institucionit nga një ndihmësmjek në kushtet e infermierisë së institucionit. Pasi u pa anamneza e të dënuarit, si dhe u morën informacione dhe sqarime nga stafi për ngjarjen, i dënuari duhej të dërgohej në Spitalin e Peqinit për një asistencë të specializuar kirurgjike, por nuk ishte dërguar për mungesë të autoambulancës së institucionit. Ekspertët e MKPT-së lidhur me këtë ngjarje zhvilluan një hetim të plotë duke egzaminuar pamjet filmike të ngjarjes dhe duke administruar dokumentat shkresorë në të cilët pasqyroheshin rrethanat e ngjarjes dhe veprimet apo mosveprimet e sektorëve përgjegjës për menaxhimin e kësaj ngjarje. Ngjarja rezultonte e rëndë dhe serioze përse i përket sigurisë së jetës të të lënduarit gjithashtu dhe në cënim të sigurisë së institucionit. Sipas pamjeve filmike rezultoi se grupi i gatshëm kishte ndërhyrë vetëm pasi katër të burgosur kishin goditur dhunshëm për disa minuta rresht duke e lënë të dëmtuar shtetasin Mario Bejdollari. Kjo vonesë në ndërhyrje kërkon një analizim të thellë në hartimin dhe zbatimin e skemës së sigurisë dhe veprimeve në institucion pasi ruajtja e jetës dhe sigurisë në IEVP duhet të jenë parësore.

Gjithashtu rezultoi se Drejtoria e Institucionit dhe Zyra Juridike nuk ishin njoftuar sipas procedurave nga sektori i sigurisë për delegimin për

kompetencë Sektorit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale në Prokurorinë e Rrethit Elbasan dhe se ishin bërë tentativa që kjo vendimarrje t'i jepej si zgjedhje personale personit të dëmtuar.

Kushtet materiale

Grupi i monitorimit mblodhi informacion dhe monitoroi aspektet e ndryshme të kushteve materiale të të burgosurve në institucion dhe u përqëndrua kryesisht te ushqimi dhe shërbimi në kohë i vakteve, ndriçimi, ventilimi, ngrohja, ambientet e takimit me familjarët, komunikimi telefonik, kushtet e banimit, veshja, mbipopullimi, higjena personale, kushtet sanitare dhe monitorimi me kamera i ambienteve të përcaktuara sipas skemës së sigurisë.

Ushqimi në institucion shërbehej në tre vakte gjatë ditës. Nga biseda me të dënuar/paraburgosur në këtë I EVP dhe nga vizita në kuzhinën e institucionit rezultoi se ushqimi i pregatitur për vaktin e drekës ishte i cilësisë së kënaqshme, mjedisi ishte i pastër, por kuzhina dhe magazina e ushqimeve kishin nevojë për higjenizim dhe dizinfektim sepse kishte insekte të kuzhinës (të quajtura furrta).

Lidhur me ambientet e kuzhinës, rezultoi se ambientet ku gatuhej dhe magazinohej ushqimi mbaheshin të pastra. Personat përgjegjës ishin të pajisur me doreza, u verifikua gjithashtu pajisja e tyre me librezë shëndetësore, si dhe kampionët e menysë ditore ruheshin në kushte frigoriferike.

Gjithsesi, nga biseda me punonjësit e kuzhinës mësuam se në këtë ambient gatuhej në mënyrë të diferencuar për banorët me regjim ushqimor të kushtëzuar për shkak të sëmundjeve (psh diabetikët). Megjithatë, grupi monitorues nuk konstatoi ruajtjen e kampioneve të ushqimit për këtë kategori banorësh. Përgjithësisht të dënuarit u ankuan për cilësinë e ushqimit dhe moslarmishmërinë e tij.

Sikurse dhe më lart, mbipopullimi përveçse paraqitet në shifrat e lartpërmendura, ndër të tjera ka shkatuar mosfunksionimin si të tilla të dhomave të observimit, për shkak se në I.E.V.P Peqin marrja e masave të sigurisë për shmangien e incidenteve në sektorët e kreyerjes së dënimit, i ka detyruar drejtuesit e këtij institucioni të përdorin të gjithë hapësirat e tij për strehimin e banorëve, ndër të tjera edhe vetë ambientet e observimit, të cilat përdoren si dhoma strehimi për të dënuar me konflikte, duke humbur misionin e tyre parësor.

Mjediset e korridoreve, banjat, dushet dhe kuzhina e institucionit ishin të pastra dhe të higjenuara. Në seksionin e sigurisë së zakonshme kishte dhoma për aktivitete të përbashkëta të pajisura varfër, por që gjithsesi të dënuarit kërkonin që të përdorej për një kohë më të gjatë.

Në aspektin e kushteve higjenike, kryesisht atë të furnizimit me ujë të rrjedhshëm, u informuam se në këtë institucion vazhdonte që uji i rrjedhshëm të ishte me orar të reduktuar, pavarësisht masave të marra nga drejtoria. Gjithsesi, nga drejtoria pavarësisht orarit të reduktuar, ishin marrë masa që të realizohej dushi sipas një grafiku një herë në shtatë ditë.

Dushet në seksionin e sigurisë së zakonshme nuk funksiononin për shkak të mirëmbajtjes së keqe dhe vështirësive të buxhetit të institucionit

Problematike paraqitej gjëndja në katër sektorë të Sigurisë së Lartë, ku në dhomat respektive nuk kishte banjo. Lidhur me këtë fakt, fillimisht duhet theksuar se mungesa në fjalë ka ardhur si rrjedhojë e mosparashikimit në projektin e fundit restaurues të impelementuar tashmë në këtë I EVP. Gjithsesi, gjëndja në këtë aspekt paraqitej mjaft problematike, ku 60 të dënuar të dy sektorëve të sigurisë së lartë në katin e parë të seksionit të sigurisë së lartë dhe po aq në katin e dytë të këtij seksioni, ishin të detyruar të frekuentonin banjo të përbashkëta. Duhet mbajtur në vëmendje gjithashtu se ambienti i banjove në fjalë përdorej dhe për shërbime të tjera, si p.sh. për të mbushur ujë, për të larë rrobat vetjake etj. Në vijim, paraqitej e pashmangshme higjena e munguar, pajisjet hidrosanitare të dëmtuara ndër të tjera dhe për shkak mbipopullimit në këto ambiente.

Në paraburgim dushet ishin të përbashkëta. Ambienti në fjalë përbëhej nga 10 poste dushi, ndërkohë që vetëm gjysma ishin funksional, megjithëse edhe këta pa dorezë dhe kokë dushi.

Në I EVP Peqin, ekziston një lavanderi e cila funksionon dhe përdoret për të plotësuar nevojat e institucionit për larjen e rrobave të fjetjes të dënuarve/paraburgosurve por jo të rrobave të tyre personale. Të dënuarit/paraburgosurit nuk mund të lanin veshjet e tyre në institucion, por duhej t'i lanin me dorë në dhomat e tyre;

Grupi monitorues konstatoi se në ambientet e këtij institucioni mungonin posterat me të drejtat e të dënuarve/paraburgosurve.

Në ambiente e kryerjes së dënimit mjetet akomoduese si tavolinë dhe karrige, në dhoma paraqiteshin në gjendje të mirë. E njëjta gjendje paraqitej dhe në drejtim të cilësisë së batanijeve dhe çarçafëve. Gjithsesi, problematike në ambientet e paraburgimit ishte mospajisja e dhomave të banimit majftueshmërisht me dollape për rroba, të cilat në kushtet e mungesës së tyre bënte që të paraburgosurit të mbanin rrobat në qese plastike ose në thes, kryesisht poshtë shtretërve.

Një problematikë tjetër e pa zgjidhur, kishte të bënte me mosfurnizimin në sasi të mjaftueshme të të dënuarve/paraburgosurve me produkte të higjenës së përbashkët dhe personale si detergjentë, qese plehrash, shampo, etj.

Sistemi i monitorimit

Në drejtim të sistemit të monitorimit të ambienteve më kamera, I EVP Peqin për shkak të strukturës bashkëkohore të saj nuk paraqitet problematike.

Gjithsesi nga monitorimi u konstatua se hapësira e shkallëve zbritëse të katit të dytë të sektorëve të Sigurisë së Lartë për në ambientet e ajrimit, nuk ishte e monitoruar me kamera.

Regjimi dhe aktivitetet

Grupi i monitorimit u informua lidhur me respektimin e së drejtës së të dënuarve për të pasur kontakte me familjarët dhe vëzhgoi në vend dhomat e takimit.. Si dhe në I EVP të tjera, u vu re mungesa e një ambienti takimi të përshtatshëm për fëmijë. Të gjithë të dënuarit/paraburgosurit dilnin për ajrim dy herë në ditë. Ambientet e ajrosjes ishin të mjaftueshme, ndërkohë që

nevojitet detyrimisht mbulimi me strehë i një pjese të tyre, pasi në rastet kur moti është me reshje apo në temperatura të larta, përdorimi i ambienteve në fjalë bëhet gati i pamundur.

Të dënuarit u ankuan gjatë bisedave konfidenciale me ta se vendet e takimit me familjet për sektorin e sigurisë së zakonshme nuk ishin të përshtatshme për takime me fëmijët dhe familjarët e tyre; dhoma e takimit të vecantë ishte e papastër dhe e pajisur shumë varfër.

Shërbimi mjekësor dhe psiko-social

Organika e sektorit të shëndetësor përbehej nga tre mjekë, por vetëm një mjekë punonte në këtë institucion. Ka një stomatolog, një ndihmës mjek/farmacist, një laborant dhe 7 ndihmësmjekë.

Gjatë inspektimit tonë në këtë institucion si dhe në bazë të intervistave me të dënuarit, u konstatua se shërbimi shëndetësor në këtë institucion ishte jo i mirë e me problematika, si për sa i përket përgjigjes në kohë të kërkesave për vizita, ashtu edhe për konsultat jashtë institucionit me mjekë specialiste në spitalin e rrethit. Kjo për shkak edhe të mungesës së mjekëve, pasi me kapacitetin që ka ky institucion duheshin, së paku tre mjekë, të punësuar në këtë sektor.

Shërbimi shëndetësor në këtë institucion ofrohej në një ambient të veçantë i cili shërbente si spital. Aty kishte 4 dhoma të cilat akomodonin 5 të dënuar, që ishin të shtruar me probleme të shëndetit fizik, me patologji kardiake, nefrologjike, neurologjike etj. Edhe këta të dënuar kishin ankesa për sa i përket mungesës së ilaçeve e shërbimit të konsultave jashtë institucionit. Kishte të sëmurë kronik, të cilët megjithëse ishin të diagnostikuar e nën mjekim, kishin nevojë për rivlerësim më të shpeshtë të ecurisë së sëmundjes e për rrjedhojë edhe të mjekimit. Të dënuarit ankoheshin edhe për mbulimin me ilaçe për të sëmurët kronik nga ana e institucionit. Kishte vonesa në vënien në zbatim të skemës së rimbursimit të ilaçeve sidomos për rastet me sëmundje akute. Shumica e të dënuarve i siguronin medikamentet privatisht nga familja.

Në këtë institucion, trajtoheshin nga ana e sektorit shëndetësor, 34 të dënuar me probleme të shëndetit mendor dhe 32 të dënuar abuzues me substancat narkotike.

Kushte e përgjithshme në këtë ambient ishin të mira. Dhomat e pacientëve mbaheshin të pastra e me rregull nga personeli sanitar i stafit shëndetësor.

Ambulanca mungonte prej kohësh në këtë institucion.

Dhoma e mjekut ishte e rregullt dhe e mirëmbajtur. Të njëjtën gjë mund të themi edhe për dhomat e stomatologut dhe farmacistit. Ato ishin në kushte fizike dhe materiale të mira dhe të rregullta. Dhoma e stomatologut ishte e pajisur me unit, autoklavë, të cilat funksiononin mirë, por mungonin materialet dhe instrumentet dentare.

Nga këqyrja e dokumentacionit të stafit mjekësor e në veçanti ai i mjekut u konstatua ekzistenca e një regjistri vizitash, themeltar i të sëmurëve kronike, regjistri për konsultat jashtë institucionit. Të gjithë formatet e kontrollit mjekësor ishin të mbajtura me rregull. Regjistrat e informacionit 24 orësh të infermiereve, gjithashtu. Kartelat mjekësore kishin mangësi, nuk ishin të plotësuara në mënyrë korrekte dhe nuk mbaheshin të mbyllura me çelës. Me

libreza shëndetësore ishin të pajisur vetëm 120 të dënuar. Pjesa tjetër që ishin transferuar nga I EVP-të e tjera prisnin plotësimin e dokumenteve përkatëse për vazhdimin e procedurës së pajisjes me libreza shëndetësore . Në fund të vizitës u takuam me stafin e sektorit të kujdesit social dhe u njohëm me aktivitetet dhe programet që zbatoheshin në institucion si dhe pamë me zgjedhje disa dosje psiko-sociale të të dënuarve. Mund të themi se sektori i kujdesit social ishte brenda në të gjitha seksionet gjatë vizitës sonë dhe na shoqëruan përgjatë vizitës. Ata kishin programe individuale të trajtimit për të dënuarit si dhe organizonin aktivitete të përbashkëta me të dënuarit, kryesisht diskutime në grup për tema sociale dhe aktivitete sportive. Dosjet psiko-sociale të të dënuarve të moshës 18-21 vjec ishin të gjitha të plotësuara dhe të freskuara me përmbledhjet nga takimet e fundit me të dënuarit. Një problem që ishte evident për sektorin e kujdesit social ishte mungesa e mjediseve të vecanta brenda në seksione për punën me të dënuarit, mungesë që ndikon në mënyrë të vecantë impaktin e punës së stafit me të dënuarit. Në fund të vizitës u zhvillua një takim përmblyllës me drejtorin e I EVP Peqin, me të cilin u biseduan të gjitha çështjet e prezantuara në raport dhe për të cilat drejtori vlerësoi që do të ndërmerre hapa për t'ë zgjidhur çështjet që i përkisnin detyrave dhe përgjegjësi të tij.

Për sa më sipër, bazuar në pikën 3, të nenit 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku parashikohet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”*; nenit **21/b të Ligjit Nr. 8454 dt. 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”**, i ndryshuar, ku parashikohet se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”*, nenin 74/1, pika “b”, të Ligjit Nr. 9888 dt. 10.03.2008, *“Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 8328 dt. 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”*, ku ndë të tjera parashikohet se: *“Avokati i Popullit nëpërmjet Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës ka këto kompetenca: b) paraqet rekomandime për organet përkatëse, me qëllim që të përmirësohet trajtimi dhe kushtet e individëve që u është hequr liria dhe të parandalohet tortura dhe trajtimi ose dënimi i egër, çnjerëzor dhe poshtëruës”*, referuar gjithashtu neneve 24, 26, 27, 28,33, 35, 41, 39 dhe 42 të Ligjit Nr. 8328 dt. 16.04.1998 *“Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve dhe të paraburgosurve”*, i ndryshuar, si dhe pikave 22, 23, 24, 26, 27, 29, 32, 59 dhe 57 të Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve, miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 303, datë 25.3.2009, i ndryshuar,

REKOMANDOJMË :

1. Marrjen e masave të menjëhershme për uljen e mbipopullimit në I EVP-Peqin dhe respektimin e hapësirës personale.
2. Marrjen në analizë të ngjarjes me pasoja rrezikimin e jetës të të paraburgosurit Mario Bejdollari të dt 9.05.2014 dhe arsyet pse kjo ngjarje nuk është dërguar për kompetence pranë Sektorit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale në Prokurorinë e Rrethit Elbasan dhe analizimi i

ligjshmërisë të tentativave që kjo vendimarrje t'i jepej si zgjedhje personale personit të dëmtuar.

3. Rregullimin e menjëhershëm të dusheve në sektorine e sigurisë së zakonshme me qëllim ofrimin e larjeve të të dënuarve më shpesh, sidomos në këtë periudhë vere.
4. Pastrimin e mjediseve për takime me familjarët dhe pajisjen e tyre me sende të domosdoshme që krijojnë klimën e një takimi familjar në respect të dinjitetit të të dënuarve dhe familjarëve vizitorë në institucion.
5. Rishikimin e mundësisë që të dënuarit të shfrytëzojnë mjediset e përbashkëta dhe në orarain e pasdites, vecanërisht për të dënuarit në seksionin e sigurisë së zakonshme.
6. Studimin e mundësisë për mjedise të punës me të dënuarit për punonjësit e sektorit të kujdesit social brenda në seksionet e institucionit.
7. Gjetjen e zgjidhjes për vendosjen e kutisë së kërkesë/ankesave që duhet të ekzistojë në seksione, mundësisht afër me telefonin, që të dënuarit ta shfrytëzojnë të drejtën e ankimit. Përcaktimin e një procedure për nxjerrjen e kërkesë/ankesave nga seksionet, rregjistrimin e tyre në regjistër dhe manaxhimin e kthimit të përgjigjeve apo zgjidhjes së tyre brenda afateve të përcaktuara në ligj.
8. Afishimin e menuse javore të miratuar në kuzhinën e institucionit, si dhe mundësisht të afishuar brenda në seksione në fillim të cdo jave.
9. Higjienizimin dhe dizinfektimin e kuzhinës dhe magazinës së ushqimeve në mënyrë periodike.
10. Gjetjen e një zgjidhjeje për të ofruar shërbimin e lavanderisë për të dënuarit (veshjet e tyre) nga institucioni.
11. Mbajtja e kontakteteve të rregullta midis IEVP Peqin dhe sektorit të ekzekutimit të vendimeve penale në Prokuroritë e Rrethit Elbasan si një detyrim ligjor dhe njoftimi i tyre për ngjarje të rënda si: plagosje të të dënuarve (rasti i M. Bejdollarit në IEVP Peqin) duhet të jetë i detyrueshëm. Rekomandojmë që të njihet stafi manaxhues i IEVP-se dhe sektori juridik për këtë detyrim nëpërmjet një udhëzimi të nxjerrë nga Drejtori I Institucionit.
12. Marrjen e masave urgjente për shtimin në organike e të paktën dy mjekëve të tjerë në sektorin shëndetësor.
13. Marrjen masave urgjente për furnizimin me medikamente të farmacisë së spitalit duke vënë në zbatim skemën e rimbursimit të ilaçeve.
14. Marrjen e masave të menjëhershme për rivlerësim, të diagnozës dhe mjekimit, të të dënuarve me sëmundje kronike.
15. Marrjen e masave të menjëhershme për pajisjen e këtij institucioni me autoambulancë.
16. Marrjen e masave për pajisjen e të gjithë të dënuarve me libreta shëndetësore, duke përshpejtuar procedurën e plotësimit me dokumente përkatëse në rastet e transferimeve nga një IEVP në tjetrën.
17. Marrjen e masave të menjëhershme për furnizimin e shërbimit stomatologjik me instrumente e materiale dentare.

Në përputhje me nenin 22, të Ligjit Nr.8454 date 4.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, ku përcaktohet se;

“Organet të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar një rekomandim, kërkesë apo propozim për shkarkim, duhet ta shqyrtojnë rekomandimin, kërkesën apo propozimin për shkarkim dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit të rekomandimit, kërkesës apo propozimit për shkarkim”, të na vini në dijeni për qëndrimin tuaj ndaj këtij rekomandimi, brenda afatit ligjor.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

AVOKATI I POPULLIT

Igli TOTOZANI

Në mungesë dhe me Porosi

K O M I S I O N E R I

Arben SHKËMBI